



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË

Sekretaria

Nr. Prot.

Tiranë, më .02.2024

**MBLEDHJA Nr. 3,
Datë 06.02.2024, ora 10:00
e Bordit të ERE-s**

Në zbatim të (i) nenit 13 dhe 16, të Ligjit Nr. 43/2015, “Për Sektorin e Energjisë Elektrike”; i ndryshuar, (ii) nenit 9, të *Rregullores së Brendshme të Organizimit dhe Funksionimit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE)*, miratuar me vendimin e bordit të ERE nr. 199, datë 27.11.2020 dhe (iii) nenit 8 dhe 11, të *Rregullores për Organizimin, Funksionimin dhe Procedurat e ERE-s*, miratuar me vendimin e bordit të ERE nr. 96, datë 17.06.2016, njoftojmë se **ditën e martë, datë 06.02.2024, ora 10:00**, do të zhvillohet mbledhja nr. 3 e Bordit të ERE-s, sipas këtij rendi dite:

1. Mbi miratimin e procesverbalit të mbledhjes së Bordit të ERE-s më datë 29.01.2024.
2. Mbi kërkesën e shoqërisë “IDI 2005” shpk për licencim në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga Hec Arçova.
3. Mbi kërkesën e shoqërisë “Yildirim Energy Europe Albania” shpk për dhënien e autorizimit nga ERE për ndryshimin e ortakut që kontrollon interesat e saj.
4. Mbi kërkesën e shoqërisë “Erseka Solar Park 1” shpk për marrjen e autorizimit të ERE-s për vendosjen e kuotave të saj si kolateral për garantimin e detyrimit ndaj të tretëve.

Palët e interesit për pjesëmarrje në mbledhjen e bordit të ERE-s, në ambientet e ERE-s ose nëpërmjet platformave të teknologjisë së komunikimit elektronik (online), duhet të dërgojnë me shkrim kërkesën për pjesëmarrje, në postën elektronike, në adresën erealb@ere.gov.al, jo më vonë se 24 orë para datës së njoftuar të mbledhjes, si dhe mënyrën e pjesëmarrjes dhe çështjen të cilën janë të interesuar të ndjekin.

**KRYETARI
Petrit AHMETI**